



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:153089

Datë: 11.11.2020

Numri i dokumentit: 01262411

P.nr.349/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sabedin Mushica, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Igballe Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.R i të cilin sipas autorizimit e mbron avokat Faruk Brestrovci nga Gjilani, dhe M. R nga Gjilani, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës(KPRK-ës)¹, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.352/2017, të datës 10.03.2017, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 06.10.2020, i shpallur me datë 09.10.2020, ndërsa i përpluar me datë 06.11.2020, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. R, nga babai A., nëna Z., e lindur M., i lindur me datë ..., Komuna e Gjilanit, me vendbanim në Gjilan, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar si taksist, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP²-ës,

REFUZOHET AKUZA

I.

Sepse me datë 25.02.2017, rreth orës 16:10 min, pas një mosmarrëveshje fillimisht verbale, në mes të pandehurit B.R. dhe S. K, i pandehuri B., thërret në ndihmë vëllaun e tij të pandehurin M. përmes telefonit, i cili i bashkangjitetkëtij të pandehuri dhe më atë rast e sulmon fizikisht S. K, duke e goditur më grushtë në kokë, ku ndërhyën dëshmitari A. Sh dhe i ndanëm dhe nga këto goditje të njejtit i kanë shkaktuar edhe lëndime të lehta trupore të përshkuara si në raportin mjekësor me numër ... të datës 25.02.2017.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

-me çka kishte për të kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës

Pala e dëmtuar S. K nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurire juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës, për veprën penale për të cilat është refuzuar akuza.

I akuzuari M.R, nga babai A., nëna Z, e lindur M.i, i lindur me datë ... e Gjilanit, me vendbanim në Gjilan, , ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

II.

Sepse me 25.02.2017, rreth orës 16:10 minuta, në rrugën e Ferizajit, pas një mosmarrëveshje fillimisht verbale, në mes B. R me të dëmtuarin S. K, ku B. e thërret në telefon të akuzuarin M., duke e goditur me grusht në kokë dhe si rezultat i goditjes të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor të përshkruara në raportin mjekësor me numër ... e datës 25.02.2017. ashtu që pasi që ky arrin në vend të ngjarjes e sulmon fizikisht të dëmtuarin S. K,

-Me çka ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 73, dhe 74 të KPRK-ës, nenin 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjetë) ditësh, të cilin dënim do ta mbajë në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë.

Koha e kaluar në paraburgim edhe atë nga data 25.02.2017 e deri më 17.03.2017, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

I dëmtuari S. K nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Detyrohet i akuzuari, që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30€(tridhjetë) Euro si dhe shumë prej 30€(tridhjetë)Euro, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Arsyetim

Historiku i procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 13.03.2017, në këtë gjykatë ka dorëzuar, aktakuzën me numër PP.II.nr. 352/2017 të datës 10.03.2017, kundër të akuzuarve S. K nga Gjiilani, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe të akuzuarve B.R dhe M. R që të dy nga Gjiilani, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor në bashkëveprim nga neni 188 paragrafi i 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës³.

Gjykata, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin Gjyqësore-publike, të cilat shqyrtime kanë vazhduar deri më datë 06.10.2020, në të cilin ka prezantuar Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Gjiilan, e cila gjatë tërë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së paraqitur, ndaj të akuzuarit M. R, duke i propozuar gjykatës që të njejtin ta shpall fajtorë dhe ta dënoj në bazë të ligjit, ndërsa për të akuzuarin B.R, është tërhequr nga akuza ngase nuk ka rezultuar se i njejtin ta ketë goditur të dëmtuarin S. K.

I dëmtuari S. K ka deklaruar se i bashkangjitet ndjekjes penale dhe se do të paraqet kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari M. R, në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim lirues, me arsyetimin se edhe pse e ka goditur ky nuk ka faj.

Pretendimet e refuzuara

Gjykata në kuptim të nenit 123 paragrafi 5 të KPP-ës, e ka refuzuar me aktvendimin procedural, propozimin e prokurorisë që si provë të lexohet deklarata e të akuzuarit S. K e dhënë në Stacionin Policor në Gjiilan me datë 25.02.2017, për faktin se i njejtin në të njejtën aktakuzë së lartcekur ka qenë i akuzuar për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-ës, mirëpo me aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr.236/2017 i datës 03.04.2017, është shpallur fajtorë dhe është dënuar me dënim përkatës, andaj në raport me të akuzuarit M. R, S. K e ka patur cilësinë e të dëmtuarit, ashtu që edhe është dnëgjuar në cilësi të dëshmitarit⁴.

Provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuarit M. R, nuk e kishte pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilat akuzohet, gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova:

- Deklarata e të akuzuarit B. R e dhënë në polici me datë 25.02.2017
- Deklarata e të akuzuarit M. R e dhënë në polici me datë 25.02.2017
- Deklarata e dëshmitarit e dëshmitarit A. Sh e dhënë në polici me datë 25.02.2017
- Deklarata e dëshmitarit A. Sh e dhënë në prokurori me datë 03.03.2017
- Deklarata e dëshmitarit H. Z e dhënë në polici me datë 25.02.2017
- Raporti Mjeksësor me nr. ...i datës 25.02.2017 në Emërgjencën e Spitalit në Gjiilan.

³ Me aktgjykimin e kësaj P.nr.236/2017 i datës 03.04.2017, i akuzuari S. K është shpallur fajtorë dhe është dënuar me dënim përkatës, ndërsa procedura me aktvendim procedural është veçuar për të akuzuarit B. R dhe M.R.

⁴ Në shqyrtimin gjyqësor të datës 06.02.2020, prokurorja e shtetit e ka propozuar që i dëmtuari S. K., të ndëgjohej në cilësi të dëshmitarit.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitari S. K, në shqyrtimin gjyqësor në mes tjerash ka deklaruar: se me M. dhe B, prej pas luftës janë në mosmarrëveshje edhe ate për një prone, me datë 25.02.2017 ka qenë duke punuar taxi te stacioni i autobusave e ka parkuar automjetin e tij në parkingun e dedikuar për taxist, ku B. ka ardhur me një kerr, dhe është parkuar para këtij dhe se i njëjti ka qenë duke punuar taxi, pasi që është parkuar ka dalur prej kerrit dhe me telefon me dorë është sillur rreth veturës së tij dhe ka biseduar me dikën në telefon, ku edhe e hapi bagazhin e veturës së tij, ashtu që ka dalur jashtë veturës së tij dëshmitari dhe ka qëndruar tek dera e shoferit dhe gjatë kësaj kohe B. e ka sharë me fjalë të ndryshme dhe ky vetëm e ka dëgjuar, gjatë kësaj kohe ka ardhur M. me një shokë të tij, mirëpo emri nuk i kujtohet. M. e ka goditur një herë në kokë me grusht dhe i njëjti ka ikur, ndërsa B. nuk e ka goditur fare.

Nga leximi i deklaratës së akuzuarit B.R, e dhënë me datë 25.02.2017, pranë Stacionit Policor në Gjilan, u konstatua se i njëjti e konfirmon se me datë 25.02.2017 rreth orës 16:00 deri ishte me veturën e tij taxi, i parkuar te stacioni autobusëve, ka ardhur K. të cilin e njeh sepse kanë patur konflikti më herët dhe me tu ofruar afër veturës afro 2 metra ia ka vërejtur një thikë që mbante në dorën e djathtë dhe e ka vërejtur vëllaun e tij M. që vinte në ato momente në drejtim e tij, duke e pa S. se don ta sulmoj, ku M. ka shpejtuar dhe e ka shty që të largohet dhe ky ka dalë nga vetura, ku M. dhe S. u shtynin në mes veti.

Nga leximi i deklaratës së akuzuarit M. R, e dhënë me datë 25.02.2017, pranë Stacionit Policor në Gjilan, u konstatua se i njëjti konfirmon se me datë 25.02.2017, rreth orës 16:15 ka qenë së bashku me shokun e tij A. Sh, ku ishim në drejtim të qytetit mirëpo kur kanë arritur tek stacioni i autobusave saktësisht tek taksistat, e ka vërejtë automjetin e vëllaut të tij .B i cili punon taxi dhe kishte shkuar S. K edhe ai punon taxi dhe janë fqinj, i njëjti në dorën e djathtë kishte pasur diqka mirëpo nuk ka mundur saktë ta identifikojë dhe i akuzuari M. është afruar te të njëjtit me qëllim për ta larguar sepse dy apo tri ditë kanë pasur problem në mes veti.

Nga leximi i deklaratës së dëshmitarit A. Sh, e dhënë me datë 25.02.2017, pranë Stacionit Policor në Gjilan, u konstatua se i njëjti konfirmon se me datë 25.02.2017 rreth orës 16, ishte me shokun e tij M. R, ku në telefon e ka thirrur vëllai i tij B. për shkak se një person (voztës taksie) më të cilin janë në probleme po ndiqte B.Dëshmitari fillimisht nuk ka dashur që të shkojë, mirëpo pas insistimit të M. i njëjti ka shkuar tek taksistat përballë stacionit të autobusëve. Kur janë ofruar aty, B. ka dalë nga vetura e më pas edhe vozitësi i taksisë mbrapa duke dashur të dalë nga vetura, M. e ka goditur me grusht, pas kësaj janë larguar me veturë në drejtim të stacionit policor në Gjilan.

Nga leximi i deklaratës së dëshmitarit A. Sh, e dhënë me datë 25.02.2017, pranë Prokurorisë Themelore në Gjilan, u konstatua se i njëjti konfirmon se ka dhënë deklaratë në polici dhe qëndron pranë të njëjtës, sa i përket përshkrimit të rastit faktik ka theksuar se ishte së bashku më M. R, tek qendra tregtare..., ku në një moment e ka ftuar përmes telefonit vëllai i tij B., dhe i tha eja të shkojmë tek shtëpia dhe unë së bashku me M. jemi nisur në drejtim të stacionit të autobusëve aty ku punon zakonisht B. me automjetin e tij si taksi dhe me të arritur në vendin e ngjarjes jashtë automjetit e ka parë B., deri sa S. K ka qenë në automjet dhe në momentin kur ka dal nga automjeti S., M ka shkuar në drejtim të tij dhe e ka goditur njëherë dhe nuk e ka lejuar S. që të dal nga vetura.

Dëshmitari A. Sh, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, në mes tjerash ka deklaruar: se me datë 25.02.2017, ka qenë së bashku me M. duke pirë kafe te ..., pas përfundimit të kafes kanë vazhduar për në shtëpi në këmbë për në shtëpi, ku edhe është përshëndetur me M., mirëpo i njëjti i ka thënë hajde shkojmë bashkë se unë po shkojë te B., ku B. ka qenë duke punuar taxi, mirëpo nuk i kujtohet se B. a e ka ftuar M. në telefon, mëtutje dëshmitari ka deklaruar se i është

kujtuar se B. e ka ftuar në telefon, M. Me të arritur tek lokacioni i taxistave mbrenda në veturë e ka parë B. dhe mbrapa veturës së B., ka qenë Sabia me veturë i cili ishte mbrenda, dhe kur janë ofruar S. ka dalur prej veturës dhe e ka sharë B. dhe M., dhe pas kësaj M. e ka goditur S. në fytyrë, më tutje ka deklaruar se S. ka qenë mbrenda në veturë dhe në momentin kur ka dalur prej veturës S., M shkaur ën drejtim e tij dhe e ka goditur një herë, ku dëshmitrai nuk ka marrë kurfarë veprimi për ti ndarë për shkak së të njejtit janë ndarë vetë.

Nga leximi i deklaratës së akuzuarit B. R, e dhënë me datë 25.02.2017, pranë Stacionit Policor në Gjilan, u konstatua se i njejtë derisa ishte me veturën e tij, duke punuar si taxist, ishte i parkuar te stacioni i autobusëve ku edhe është parkingu për taxista, ka ardhur S. K të cilin e njuh sepse më heret kanë pasur konflikt dhe kur i është ofruar afër veturës së tij, në afërsi rreth 2 m i ka vërejtur një thikë që e mbante në dorën e djathtë. E ka vërejtur vëllaun e tij M., duke ardhurë në ato momente në drejtimin e tij, dhe duke e parë Sabrinë se do ta sulmojë B., M. e ka shtyer shpejt atë që të largohet ku edhe ky ka dalur nga vetura, në ato momente M. dhe S. ishin duke u shtyer në mes veti, e kapa vëllaun e tij për dore dhe kanë hyrë në veturë dhe kanë ardhurë në stacionin policor për ta lajmëruar rastin.

Nga leximi i deklaratës së akuzuarit M. R, e dhënë me datë 25.02.2017, pranë Stacionit Policor në Gjilan, u konstatua se i njejtë me datë 25.02.2017 rreth orës 16:15, ishte së bashku me shokun e tij A. Sh. dhe ishim në drejtim të qytetit mirëpo kur kanë aritur tek stacioni i autobusave saktësisht te taksistat, ka vërejtur te automjeti i vllaut të tij ishte shkuar S. K. i cili edhe ai punon taxi edhe janë fqinj, në dorën e djathtë kishte pasur diçka mirëpo nuk ka mundur saktë ta identifikoj dhe është ofruar te i njëjtë me qëllim për ta larguar sepse dy apo tri ditë kanë pasur problem në mes veti, më tutje ka deklaruar se askush nuk e ka thirrur, mirëpo rastësisht ka qëlluar aty.

Nga raporti mjekësore i lëshuar nga emergjenca e Gjilanit me numër ... datës 25.02.2017 në emër të S. K, gjykata ka konstatuar faktin se i njejtë pas përfundimit të ngjarjes, ka kërkuar ndihmë mjekësore.

Deklarata mbrojtëse e të akuzuarve

I akuzuari B. R, në shqyrtim gjyqësor në mes tjerash ka deklaruar: se në kohën kur ka ndodhur incidenti ky ka qenë duke punuar taxi, ashtu që atë ditë ka dalur për të punuar dhe kur ka shkuar tek vendi ku i parkojnë veturat, S. nuk ka qenë aty, dhe se atë ditë, rrespektivisht paradite ka folur me telefon me M. para se me ndodhë rasti nuk ka folur në telefon me M., ashtu që kur ka ardhur S. me veturë, ky ka qenë mbrenda në veturë dhe ka qëndruar në veturë deri sa kah vërejtur M. duke ardhur, S. ka dalur prej veturës dhe sa i kujtohet këtij i njejtë ka patur në dorë një thikë nër mëngë dhe është nisur në drejtim të këtij dhe gjatë kësaj kohe i akuzuari ka qëndruar në veturë dhe kur e ka parë që ka ardhur M. dhe e dinë se janë shtyre pak e S., mirëpo a e kanë goditur njëri tjetrin nuk e dinë. Atë ditë i akuzuari B. M, nuk ka patur mosmarrëveshje me verbale me S. dhe se nuk e ka goditur të njejtin, po ashtu e ka njoftuar gjykatën prej kur ka ndodhur ky incident edhe pse janë takuar me S., mosmarrëveshje nuk kanë patur.

I akuzuari M. R, në shqyrtim gjyqësor në mes tjerash ka deklaruar, se e ka pranur fajësinë për veprën penale, mirëpo ka shtuar se për këtë nuk ka faj, duke shtuar se atë ditë ka dalur me shokun e tij A., për të pirë kafe tek..., ashtu që me të njejtin kanë qenë në këmbë dhe kanë vazhduar ... e prej rrethit kanë vazhduar te poshtë ka qendra dhe duke kaluar rastësisht tek vendi i taksistave të cilët gjenden afër stacionit të autobusëve, e ka parë vëllaun e tij, B., i cili kishte qenë jashtë veturës së tij dhe S. e ka parë duke dalur prej veturës duke e sharë me fjalë të

ndyta B., ashtu që ky i është ofruar S. duke i thënë "pse po shanë", dhe i njejt i ka filluar që ta fyej edhe këtë dhe e ka shtyer me duar, dhe pas kësaj i njejt e ka goditur S. një herë në kokë.

Vendimi për ricilsimin e veprës penale

Dispozitat relevante materiale dhe procedurale

Prokuroria Themelore në Gjilan fillimisht ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurve B. R dhe M. R, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Gjykata ka vlerësuar se pretendimet e prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes në aktakuzë dhe cilësimin juridik të veprës penale. Të gjitha këto në raport me nenin 360 të KPP-së.

Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale, ashtu që në këtë rast kanë ndryshuar pjesë të caktuara në përshkrimin e gjendjes faktike për të pandehurin M. R, në raport me veprën penale si në pikën e II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë është ndryshuar pas administrimit të të gjithë provave në këtë çështje penale në njërën anë, si dhe në anën tjetër, prokuroria ka hequr dorë nga aktakuza për të akuzuarin B.R, ashtu që është vërtetuar kjo gjendje faktike të cilës ia ka falur besimin kjo gjykatë.

Vendimi lidhur me pikën e I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi refuzues për të akuzuarin B.R

Duke e marrë për bazë faktin, se prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka hequr dorë nga ndjekja penale, për të akuzuarin B.R, gjykata ka vendosur si në pikën e I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vlerësimi dhe analizimi i provave lidhur me pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për të akuzuarin M. R

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje gjykata konform nenit 7 dhe nenit 361 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegje i ka vlerësuar çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerrë përfundim lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Nuk është kontestuese fakti se i akuzuari M. R, me datë 25.02.2017, rreth orës 16:10, ka qenë me shokun e tij A. Sh, tek vendi i taxistave i cili gjindet afër stacionit të autobusave në Gjilan, dhe aty kishin qenë B. R dhe S. K me veturat e tyre, duke punuar taxi.

Kontestuese në mes palëve ishte se të akuzuarin M. R, a e ka ftuar në telefon vëllaun i tij B. R. kti se i akuzuarit M. R, B. R dhe . Ku, kanë patur mosmarrëveshje të mëhershme edhe ditën kritike në mes vete, vërtetohen nga vet deklaratat e tyre të dhënë në stacionin policor në Gjilan dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Andaj, lidhur me këtë gjykata i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet ti falet besimi i plotë provave të propozuara nga prokuroria e shtetit të cilat në tërësi e vërtetojnë dyshim e bazuar mirë se i akuzuari M. R e ka kryer veprën penale sipas pikës së II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që të gjitha provat e prezantuara në shqyrtim kanë lidhmëri logjike, kohore, dhe janë bindëse dhe të qarta dhe janë në harmoni të plotë si me dëshmitë e dëshmitarëve ashtu edhe me provat e tjera materiale dhe gjykata konsideron se i akuzuari M., pasi që kishte qenë duke pirë kafe së bashku me shokun e tij A., e kishte thirrë në telefon vëllau i tij, B., ashtu që ky ishte nisur në drejtim të stacionit të autobusave, ku afër tij është vendi ku qëndrojnë taksistat, ku fillimisht shoku i tij A. nuk ka dashur që të shkojë më të akuzuarin M., pasi që ky e kishte njoftuar të njejtin se për çfarë arsyeje e kishte thirrur B., pasiqë i akuzuari M., ka insistuar A. ka shkuar me të, dhe me të arritur në vendin e ngjarjes, B. ka dalur nga vetura e tij, ku po ashtu edhe i dëmtuari S. K ka, dalur nga vetura e tij, dhe për një moment i akuzuari M. R e ka goditur një herë me grushtë në kokë dhe me rastin e goditjes i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, e që vërtetohet me raportin mjekësor të lëshuar nga emergjenca e Gjilanit me numër ... i datës 25.02.2017 në emër të S. K, ku pas goditjes janë larguar nga vendi i ngjarjes, ku këtë faktin e goditjes një herë me grusht e vërtetojnë deklaratat e të dëmtuarit- dëshmitarit Sabri Kryeziu, dëshmitarit A. Sh dhe nga vet deklaratat e të akuzuarit M. R, dhe po ashtu faktin tjetër se B.R e ka ftuar në telefon vëllauin e tij- të akuzuarin M. R, është vërtetuar nëpërmjet dëshmitarit A. Sh i cila ka deklaruar se “me datë 25.02.2017 rreth orës 16, ishte me shokun e tij M. R, ku në telefon e ka thirrur vëllai i tij B. për shkak se një person (voztës taksie) më të cilin janë në probleme poe ndiqte B.. Dëshmitari fillimisht nuk ka dashur që të shkojë, mirëpo pas insistimit të M. i njejtin ka shkuar tek taksistat përballë stacionit të autobusëve..”, po ashtu ky fakt është vërtetuar edhe nëpërmjet deklaratimit të dëmtuarit S. K, i cili në mes tjerash ka deklaruar.. (“Besimi ka ardhur me një kerr, dhe është parkuar para këtij, dhe se i njejtin ka qenë duke punuar taxi, pasi që është parkuar ka dalur prej kerrit dhe me telefon në dorë është sillur rrth veturës së tij dhe ka biseduar me dikë në telefon”)... Gjykata në tërësi ia fal B. deklaratës së të dëmtuarit S. K, ndërsa dëshmitarit A. Sh pjesërisht ia fal besimin edhe atë sa i përket asaj se B. e ka thirrur në telefon M., dhe se M. e ka goditur një herë në kokë, ngase deklarimi i tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte bindës dhe kishte lidhmëri me provat tjera, ndërsa sa i përket asaj pjesëve të deklaratës ku në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se S. e ka fyer M., në këtë pjesë Gjykata nuk ia ka fal besimin për shkak se e njejtin deklaratë ishte në kundërshtim me pjesën e deklaratës që e ka dhënë në stacion policor dhe në prokurori, ku në asnjë moment nuk e ka përmendur faktin se S. K e ka fyer M. R .

Gjykata ka analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit M. R., i cili ka deklaruar se e ka goditur S. njëherë për shkak se i njejtin e ka fyer dhe shtyrë , ashtu që gjykata nuk i'a ka falur besimin sa i përket asaj se kinse S. K e ka fyer dhe shtyrë, për shkak se e njejtin deklaratë ishte në kundërshtim me deklaratën e të dëmtuarit S. K. dhe dëshmitarit A. Sh.

Ndërsa sa i përket provave tjera materiale, gjykata konsideron se të njëjtat ishin i relevante dhe nga arsyet e lartcekura, të njëjtat nuk janë arsyetuar.

Vendimi për ta shpallur të akuzuarin fajtor lidhur me pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin M.R për veprën lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës, pasi që gjykata

gjeti se i njëjti është përgjegjës dhe fajtor dhe janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën akuzohet.

Rrethanat mbi bazën e të cilave është shqiptuar dënimi

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me të akuzuarin M. R, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen e të akuzuarit me gjykatën, nuk kanë patur mosmarrëveshje në mes vete edhe janë takuar deri më tani, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti, mënyrën e kryerjes së veprës penale, vendin ku është kryer verpa penale, ku numër i konsiderueshëm i qytetarëve e frekuentojnë atë pjesë.

Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale , me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Andaj gjykata duke u nisur nga të gjitha këto i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e I të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij , si dhe të përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Llogaritje e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Në 83 paragrafi 1 të KPRK-ës parashihet se “*Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë*”, andaj në rastin konkret i akuzuari M. R, ka qëndruar në masën e paraburgimit edhe atë nga data 25.02.2017 e deri me datë 17.03.2017, dhe gjykata ia llogaritë në dënimin e shqiptuar me burgim, ashtu siç ka vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin M. R, ta detyrojë t’i paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30€, si dhe shumën prej 30€, për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim te merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 463 të KPP-ës, i dëmtuari S. K, për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

P.nr.349/2017

Me datë 06.11.2020

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Numri i lëndës: 2020:153089
Datë: 11.11.2020
Numri i dokumentit: 01262411

Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.